

## MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

në bashkëpunime me

## SHOQATËN E ARKITEKTËVE TË SHQIPËRISË

Organizon

### TAKIM ME PROJEKTUES NË FUSHËN E NDËRTIMIT

#### FTESË

*Të nderuar projektues,*

Në kuadër të procesit të përmirësimit dhe lehtësimit të procedurave të aplikimit për Leje Ndërtimi, të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare, Ministria e Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, ka implementuar platformën elektronike të aplikimit për Leje Ndërtimi. Prej datës 1 shtator 2016, kjo platformë është e vetmja mënyrë aplikimi për leje në fushën e ndërtimit.

Në këtë kuadër, janë organizuar deri më tani dy trajnime me profesionistë të fushës. Nisur nga kërkesat e vazhdueshme të profesionistëve dhe angazhimi i Ministrisë për të asistuar të gjitha palët e përfshira në përdorimin e sistemit elektronik, Ministria e Zhvillimit Urban, në bashkëpunim me Shoqatën e Arkitektëve të Shqipërisë, prezanton një kalendar të ri trajnimesh. Të gjithë projektuesit (arkitektë, inxhinierë, etj.) që janë të pajisur me firmë elektronike mund të regjistrohen për të marrë pjesë në një nga datat e trajnimeve, sipas kalendarit në vijim, duke dërguar një e-mail pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban [eleje@zhvillimiurban.gov.al](mailto:eleje@zhvillimiurban.gov.al) ose Shoqatës së Arkitektëve [alb\\_ar\\_as@yahoo.com](mailto:alb_ar_as@yahoo.com), me specifikimin e datës së trajnimit për të cilën dëshirojnë të regjistrohen.

Për informacione të mëtejshme lidhur me sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit dhe përditësimet të mundshme të kalendarit të trajnimit, mund të konsultoni faqen zyrtare të Ministrisë (<http://zhvillimiurban.gov.al/al/e-lejet-e-ndertimit>).

Kalendari i trajnimeve

|   | Data | Muaji   | Ora   | Vendi  |
|---|------|---------|-------|--|
| 1 | 29   | Shtator | 17.00 | Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tirane, Salla 102 |
| 2 | 28   | Tetor   | 17.00 | Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tirane, Salla 102 |
| 3 | 25   | Nentor  | 17.00 | Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tirane, Salla 102 |
| 4 | 22   | Dhjetor | 17.00 | Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Tirane, Salla 102 |

Ju mirëpresim,

**Ministria e Zhvillimit Urban**

**Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë**